



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**SENATI AKADEMIK
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"**

Nr 174 Prot.

Gjirokastrë, më 07.02.2019

VENDIM

Nr. 05 , datë 07.02.2019

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3 pika 4/b, neni 4 pika 1, neni 23 pika 4, neni 25 pika 8, neni 38 pika 1/a dhe 3, neni 42 pika 7, neni 69 pika 3, neni 74 pika 2, neni 83 pika 1b, neni 135, neni 14 të Statutit, shkresa nr.329 datë 15.01.2019 në propozimet e njëjësive kryesore të Universitetit të Gjirokastrës, Senati Akademik në mbledhjen e datës 02.02.2019,

VENDOSI:

I- Kriteret e pranimit për studentët e Ciklit të Parë të studimeve "Bachelor", për vitin akademik 2020-2021, të jenë si më poshtë:

1. Nota mesatare e përgjithshme aritmetike, shkollës së mesme, për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore, në masën 50%.
2. Nota mesatare e gruplëndëve bërthamë (për të gjitha vitet ku shtrihen lëndët), të përzgjedhura nga fakultetet për çdo program studimi të Ciklit të Parë, në masën 50% (sipas tabelave bashkangjitur).

II-Kriter pranimi për studentët e Ciklit të dytë të studimit "Master i Shkencave", për vitin akademik 2020-2021, të jetë nota mesatare e studimeve të Ciklit të Parë ≥ 7 .

III-Kuotat e pranimit për ciklin e parë të studimeve "Bachelor", ciklin e dytë të studimeve "Master", "Master Profesional" dhe "Master i shkencave", ciklin e tretë të studimeve "Doktoraturë në Albanologji" dhe kuotat e pranimit për studimet me karakter profesional 2-vjeçar për vitin akademik 2019 - 2020 në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë sipas tabelave bashkëlidhur.

IV- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEMA

